




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1- 61
Br.

Data 23.05.2023
Datum

OBILIQ.OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.28.04.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratimir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, Berat Mehmeti, zyrtar ligjor, Fazli Përvetica, zyrtar mjedisor në Drejtorinë e ambientit, Arta Mjeku, zyrtare për kthim të qëndrueshëm dhe përf. e KFOR-it,

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese, e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Rishqyrtimi dhe aprovimi i Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2022
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023
6. Raporti financiar i shpenzimeve Janar – Mars 2023
7. Dhënia në debat publik e Planit të veprimit për transparencë 2023 - 2027
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për kompensimin e Kryetarëve të Këshillave lokale
9. Raport nga Komisioni përzgjedhës për drejtor në SHFMU "Naim Frashëri" në Breznicë
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua unanimisht.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Enver Gashi – Ne jemi për miratimin e këtij ekstrakti të procesverbalit.

Sami Ahmeti – Te pika 6 e rendit të ditës, procesverbali nuk përkon me atë se

çfarë vërtetë është folur në seancë. Te kjo pikë kishte disa pretendime të Kryetarit të Komunës, që i bëri në seancën e muajit të kaluar. Duke u nisur nga kjo mungesa e pjesës thelbësore të atij debati në procesverbal nga kjo pikë e rendit të ditës, duket hapur se është e qëllimshme, ose nuk di qysh thuhet ndryshe. Tash, kryesuese unë e di se ju nuk e bëni procesverbalin dhe jam i sigurtë se edhe znj.Zeneli, duke e njohur profesionalizmin e saj nuk është që prekë diçka në procesverbal, apo e ndryshon ose heqë pjesë të caktuara. Mua, më intereson me ditë për çka mungon pjesa kryesore e kësaj pjese të pikës së rendit të ditës dhe pse me u formue një diçka e tillë, ose me u përdorë një metodë e tillë që ato çka fliten deklaratat publike të fshihen nga procesverbali. Unë nuk kam ndonjë qëllim, por është mirë për hir të përgjegjesisë të gjitha ato që fliten pa marrë parasysh a bëjë upsa unë apo dikush tjetër, ato duhet të vendosen në procesverbal dhe të mos krijohet një rrethanë e tillë që me këto forma selektive kujt s'i pëlqen diçka me heqë.

Kryesuesja – Krejtë sa i përket rendit të ditës, siç e dijmë procesverbali është përmbledhja e diskutimeve gjatë mbledhjes dhe besoj se ajo që ka qenë në

inçizim bashkëpunëtorja e ka shenuar ndërsa, ato që nuk kanë qenë pikë të rendit të ditës, apo nuk kanë qenë në inçizim nuk ekzistojnë në procesverbal.

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 13 vota për dhe 6 vota kundër.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti rishqyrtimin dhe aprovimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Enver Gashi – Ne si grup parlamentar jemi që Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave të kaloj në këtë seancë.

Sami Ahmeti – Vetë titulli rishqyrtim do të thotë se është shqyrtue edhe një herë më heret ndërsa, unë e kam parë këtë material se është për herë të parë që ka ardhë në shqyrtim, do të thotë është dashtë të jetë shqyrtimi i Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit. Unë kisha pasë dëshirë me ditë a e keni shqyrtue bazën ligjore të këtij Plani, që sipas këtij Plani duhet të jetë një analizë e Komunës, jo vetëm mjedisore, por edhe të gjitha fushave. Sido që të jetë, është një dokument që konsideroj se është voluminoz dhe unë për shkak të disa obligimeve, që i kam pasë nuk kam pasë kohë me shqyrtue komplet, por i kam disa pyetje nëse, është dikush që mund të përgjegjet nëse, është e mundshme krejtë për këtë Plan.

Kryesuesja – Po, z.Ahmeti këtu i kemi anëtarët e Komisionit dhe e di që kanë punuar madje, kanë qenë bashkarisht të gjitha Komisionet e të gjitha Komunave me Ministrinë përkatëse dhe e kanë formulue.

Sami Ahmeti – Çka e ndryshon ky Plan gjendjen e qytetarëve për dallim prej Rregullores për mbeturina, që tashmë e kemi miratuar, cila do të jetë ngarkesa tarifore shtesë për qytetarët përveç asaj të mbeturinave, që tashmë i paguajnë, a do të ndikoj ky plan në përmirësimin e mjedisit dhe ndalimin e ndërtimit të ndotësve tjerë siç janë betonjerat, bazat e asfaltit e tjera, a parashihet reciklimi i mbeturinave me këtë plan dhe në Rregullore pjesërisht çka kam parë parashihet shpërndarja e komposterëve për ekonomitë familjare dhe restorantet, çka janë ata dhe çka iu shërbejnë qytetarëve.

Fazli Përvetica – Përgjegjet se këtë Plan e kemi punuar bashkarisht me Asociacionin e Komunave, me përfaqësuesit e GIZ-it dhe me Komisionin nga Komuna, që ka qenë në përbërje prej të gjitha Drejtorive. Ky është Draft Plan, që deri më sot i ka kaluar të gjitha procedurat, ka kaluar dëgjimin publik, ka qenë koha për komente dhe ankesa nuk kemi pasë, ndërsa sot ka ardhë në Kuvend për me marrë aprovimin prej Kuvendit. Në këtë Plan trajtohen mbeturinat dhe është në përputhje me Rregulloren. Te komposterët që e ceku

parafolësi, ne i kemi paraparë komposterët me ardhë në vitin 2024-2025 me fillue me disa pilot projekte. Ne kemi me fillue me Milloshevën, që është vendbanim pak më i madh dhe është në interes të qytetarëve dhe të Komunës sepse e zvoglon sasinë e mbeturinave që do të deponohen . Fillimisht e përcakton një fillim të kësaj pune me pa vetëdijësimin e qytetarëve në të ardhmen sa ka me ndikue ndarja në burim të mbeturinave.

Ajet Berisha – Unë e kam lexue këtë Draft Plan dhe mendoj se është kogja me ambicie. Unë kisha dashtë që datat të afrohen dhe sa më shpejt të hyn në funksion, por është për keqardhje mungesa e mjeteve dhe planifikimi që tërë kohën ose duhet donatorë, ose duhet Komuna. Do të thotë se pa marrë parasysh se Plani është komunal, si kompani e pastrimit që është regjionale që ka edhe përgjegjësi lokale, nuk është që merrë përgjegjësi diçka nga puna e vetë, që ajo të investoj. Unë e pashë edhe planin e të hyrave dhe të dalurave të realizimit do të thotë 305 mijë ka planifikim të të hyrave, ndërsa shpenzimet paga dhe material tjetër administrativ i ka dikund 286 mijë. Kjo, do të thotë se kjo kompani funksionon vetëm sa me i sigurie pagat dhe materialin administrativ, absolut nuk ka asnjë kapacitet me planifikue investime nga mjetet dhe nga të hyrat që merrë. E dyta, për me ndikue te kjo, Plani është i mirë dhe ka interes qytetari që me u realizue, por duhet edhe një performancë më e mirë. Performanca e shërbimit nënkupton menjëherë si e shehë stafin që është i angazhuar, vetë është e shkruar këtu si staf direkt edhe indirekt. Si staf direkt janë që kanë ndikim në mbledhjen, grumbullimin, transportin, që janë 22 punëtorë në kuadër të kësaj kompanie në Komunën e Obiliqit. Ndërsa, indirekt që nënkupton administratë dhe udhëheqje janë 20 punëtorë. Gati krejtë e pakuptimtë 22 punëtorë me u marrë me punën direkte për çka janë të thirrur, ndërsa 20 punëtorë me u marrë aty me dokumente, për çka. Singërisht kompania është e ngarkuar me administratë dhe për këtë arsye edhe performanca, pastaj mungon. Në planifikim që Komisioni e ka bërë kisha dashtë me na dhënë një arsye, thotë përmirësimi i efikasitetit të stafit. Në tabelën e paraqitur prej vitit 2022-2027 nuk ka asnjë rekomandim dhe për që është keq e keni konstatue dhe ka nevojë me u përmirësue, e keni dhënë këtu për rekomandim, por keni bërë një tabelë në të cilën nuk ka asnjë rekomandim, arsyeja pse.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 7 vota abstenim e miratuan Vendimin për Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2022.

Enver Gashi – Ne edhe në KPF, e kemi shqyrtuar këtë kërkesë, e kemi lavdëru këtë resor të Komunës sepse është një dukuri e mirë kur kërkohet rritja e të hyrave vetanake. Gjithmonë ka pasë rritje të të hyrave vetanake, e jo vetëm në këtë vit dhe ne jemi për aprovim.

Sami Ahmeti – Falenderimi më i madh duhet me u bë për qytetarët. Është dhënë një pasqyrim i rritjes së të hyrave vetanake, të cilin ne e mirëpresim do të thotë sa i përket neve, është gjithçka në rregullë.

Ajet Berisha – Sa herë kemi këso rritje është ose angazhim shtesë për me i mbledhë këto të hyra, ose ndonjë indikatorë tjetër i ka rritë këto të hyra. Kishte me qenë mirë zakonisht DEFZH-ja, që merret me këtë punë me na shpjegue arsyet e kësaj rritjeje. Përndryshe, kur bëhet planifikimi është gati e pamundur me pasë rritje përveç mbledhja e borxheve, që edhe kjo është një përqindje me thënë 10 % është nga mbledhja e borxheve të kaluara në rast se është ashtu, apo janë indikatorët tjerë, që kanë ndikue në ngritjen e të hyrave vetanake. Kishte me qenë mirë gjithmonë që Drejtoria me na dhënë një shpjegim, cilët janë këta indikatorë që kanë ndikue në rritjen e këtyre të hyrave, sepse të hyrat ne i planifikojmë me buxhet, përtej nuk mund të delë. Nëse, kanë shkue më shumë se sa që është planifikue, a është mbledhje e borxheve, apo ka ndikue ndonjë indikatorë tjetër.

Zarife Behluli – Sa i përket rritjes së të hyrave vetanake të vitit 2022, ju e dini mirë se me dt.18.10.2022, e kemi bërë rritjen e të hyrave prej 213,982.70 sepse planifikimi ka qenë 908,730. Tani, me dt.31.12. të hyra të inkasuara në total janë 1,318,306.34. Tani, duhet të merret vendim për rritje vetëm për 195,593.64 euro, janë kategori e të hyrave të tatimit në pronë, gjendja civile, arsimit, shkolla, shëndetësia, gjobat, denimet nga Gjykatat dhe gjobat në trafik, lejet ndërtimore. Pra, janë kategori të ndryshme të inkasimit të të hyrave nga vitet paraprake dhe nga kjo ka ardhë deri te rritja e të hyrave vetanake me tejkalue nga planifikimi i të hyrave.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e miratuan Vendimin për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2022.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që këto mjete, të barten në këtë vit dhe uroj që herave tjera, të mbeten sa më pak.

Sami Ahmeti – Rritjen e të hyrave vetanake dhe bartjen e thamë edhe në pikën paraprake që ne e mirëpresim. Ajo çka dua të shtoj është mundësia që do të duhej të iu jepet anëtarëve të Kuvendit komunal, që të jepnin propozime për fushat ku do të alokoheshin ato mjete, ku ka kërkesa dhe nevoja. Në këtë rrafsh ne kërkojmë që ti jepet prioritet Arsimit dhe Shëndetësisë. Te Arsimi shpesh kemi vërejtje se ka mungesa të theksuara të materialit administrativ dhe ndoshta, edhe atij higjienik. Mësimdhënësit shumë shpesh vazhdojnë të mos kenë letra, të blejnë letra personalisht, të bëjnë fotokopje jashtë objekteve dhe këtë nuk e them për kritikë, vetëm le ti jepet rëndësi kësaj fushe që për secilin prej neve, është shumë e rëndësishme. Ne e mirëpresim edhe këtë bartje të mjeteve.

Kryesuesja – Për këtë arsye është mirë tani, kur e kemi në muajin maj Kornizën Afatmesme Buxhetore, që të marrin pjesë të gjithë në takimet me Kryetarin dhe drejtoreshën, në mënyrë që ti japin sugjerimet dhe propozimet se ku duhet të barten këto mjete.

Anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e miratuan Vendimin për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet raportin financiar të shpenzimeve Janar – Mars 2023.

Enver Gashi – Ne e kemi lexuar me kujdes këtë raport dhe nuk kemi gjetë ndonjë vërejtje të theksuar. Ne jemi për atë që të vazhdohet me raport sepse raporti financiar për periudhën Janar – Mars, me na ardhë në prill është mirë dhe që çdo kuvendarë ta shohë nëse, ka vërejtje edhe ti jepë.

Ajet Berisha – Për dallim nga viti i kaluar në këtë vit shihet se është një shpenzim më i shpejtë i mjeteve, do të thotë 24.87, praktikisht janë mjete të shpenzuara aq sa është planifikuar për këtë 3 muaj. Mua, vetëm më intereson nga linja e subvencioneve dhe transfereve 185,520 të shpenzuara, nuk e di se në cilin sektor kanë shkue këto mjete, në cilën linjë janë ndarë.

Zarife Behluli – Përgjegjet nëse e ke tabelën raportin e shpenzimeve janar-mars, subvencione dhe transfere shihet alokimi i mjeteve dhe shpenzimi i mjeteve. Shpenzimi ka ndodhë te infrastruktura rrugore 4,275 euro, te Drejtoria e shëndetësisë, lehona 25.000 euro dhe te Drejtoria e Arsimit, bursat nga shpallja publike 2022-2023 dhe kemi arritë me i shpenzue 156,000 euro. Tash edhe në muajt në vijim në raportin tjetër keni me pasë në total shpenzimin e mjeteve nga subvencionet për Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtoritë tjera, në bazë të kërkesave dhe alokimit të mjeteve qysh është paraparë plani i alokimit dhe plani i shpenzimit.

Ajet Berisha – Bursat janë ndarë psh në vitin 2022, do të thotë është e pamundur lidhja e viteve sepse viti fiskal përfundon në dhjetor 2022, atëherë i kemi planifikue ndërsa, pasqyrimi për ndarje të bursave po reflekton që është në vitin 2023, ose në 3 muajorin e dytë.

Zarife Behluli – Sqaron se 50 %, ka qenë pagesa në vitin 2022, ndërsa në vitin 2023 është krye qind për qind. Po ashtu, kemi pasë problem edhe me mbledhjen e të hyrave vetanake, për me realizue pagesën për vitin 2023.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për dhënien në debat publik të Draft Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2027.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ky Plan i veprimit të kaloj në debat publik, pastaj do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Ne si grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, jemi dakord që Plani i veprimit për transparencë 2023-2027, të dalë në debat publik duke shprehur vullnetin për të kontribuar sa më shumë që të rezultoj me një dokument që vërtetë do ta ngriste transparencën.

Anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht e miratuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2027.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për kompensimin e Kryetarëve të Këshillave lokale në Komunën e Obiliqit. Sipas Rregullores pika 1 e nenit 16, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës, parashihet edhe pagesa e Kryetarëve të Këshillave lokale, që duhet të merret një vendim përmes Kuvendit. Kompensimi i Kryetarëve të Këshillave lokale, bëhet në vlerën financiare ekuivalente me anëtarët e Komiteteve obligative. Kompensimi për pjesëmarrje në takime bëhet vetëm për 6 takime brenda vitit.

Enver Gashi – Ne jemi për aprovim, por duhet të iu kërkohet një material secilit Kryetar të fshatit, për çdo takim së paku për këto 6 takime që kompensohen dhe natyrisht se konform ligjit dhe Rregulloreve bëhet kompensimi dhe lëshohen vendimet.

Kryesuesja – Sipas Rregullores për këtë çështje kujdeset drejtoresha e administratës dhe ata paraprakisht duhet ta njoftojnë zyren e Kryetarit për takimin.

Sami Ahmeti – E cekëm edhe në mbledhjen e KPF-së, se nxjerrja e një vendimi të tillë për pagesën e Kryetarëve të Këshillave, bazohet në Rregulloren e këtyre Këshillave dhe është shumë e nevojshme. Ne si grup e përkrahim vetëm se është me rëndësi që të ketë korrektësi dhe raportim për pagesat që bëhen sipas kësaj Rregulloreje. Ne e mbështesim.

Fidan Ahmeti – Shefi ynë lajmëroi se është për mirëpo ne si Komision që i kemi zgjedhë këta Kryetar të fshatrave, kishte me qenë mirë të kompensohemi edhe ne. Kërkesa ime nuk është direkte, por pothuajse është e gjithë grupit që kemi qenë. Sigurisht, kjo shefit i ka ikë me thënë.

Kryesuesja – Jo, nuk i ka ikë sepse e kemi diskutuar edhe në KPF dhe Drejtoria e financave, veç e ka zgjidhë këtë problem dhe patjetër se do të paguhet edhe Komisioni që e ka bërë tërë këtë punë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht e miratuan Vendimin për kompensim - pagesën për 12 Kryetarët e Këshillave lokale në Komunën e Obiliqit.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin nga Komisioni përzgjedhës për drejtor në SHFMU “Naim Frashëri” në Breznicë. Kuvendi komunal me dt.29.12.2022, ka nxjerrë një vendim ku znj.Fatime Pllana, ka qenë Kryetare e Komisionit, Bashkim Ismajli, anëtar dhe anëtari i tretë Sahit Berisha, anëtar nga MASHT-i. Këta, kanë zhvilluar të gjitha procedurat për konkursin e shpallur dhe në fund ka rezultue për drejtoreshë znj.Ragbete Gashi. Pasi që nuk kemi diskutime për këtë pikë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesja – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, ashtu siç e kemi potencuar edhe në KPF, të gjitha kërkesat që vijnë ne i adresojmë në Drejtoritë përkatëse dhe kërkojmë nga ata që në mbledhjen e Kuvendit të vijnë me një sqarim, apo të na plotësojnë me dokumente. Sa i përket kërkesës së Reis Sallovës, drejtori i DPUKP-së, na e ka dërgue një sqarim, të cilin ua kemi dërgue edhe juve dhe lidhur me kërkesën në fjalë drejtori mund të na shpjegoj në mënyrë më detale.

Arben Berisha – Edhe Drejtoria dhe Këshilli i drejtorëve, e kemi pranuar shkresën e njejtë dhe Këshilli më ka autorizue si Drejtori e urbanizmit, që me trajtue lëndën. Ne së pari i kemi bërë shkresë Infrakosit dhe kemi kërkuar një sqarim nga Infrakosi lidhur me parcelën e Infrakosit, që ballafaqohet në mes të parcelës së Komunës dhe parcelës në fjalë të parashtruesit të kërkesës. Me dt.12 prill e kemi pranuar nga Infrakosi kërkesën dhe thotë që objekti afarist ka pasë kontratë me Infrakosin, do të thotë në mes të objektit të tregut dhe objektit të parashtruesit të kërkesës të Reis Sallovës, është një parcelë e Infrakosit dhe ndodhet një biznes që e ushtron veprimtarinë e vet në mesin e këtyre 2 parcelave. Ne kemi bërë shkresë te Infrakosi se ku është gjendja e këtij biznesi dhe Infrakosi ma kthen se objekti afarist ka pasë kontratë me Infrakosin deri me dt.31.12.2022 dhe tash për vitin 2023 nuk ka kontratë me Infrakosin, kemi pasur takime me palën dhe e njejtja është njoftuar për mosvazhdim të kontratës. Bazuar në këto shkresa, unë ua kam draftuar një dokument dhe e kam sqaruar komplet çështjen. Ne si Drejtori e kemi sqaruar çështjen dhe ua kemi dhënë

një lokacion të mundshëm nëse, ju e keni vullnetin për me zhvendosë tregun pa interferue në vendimin e juaj.

Kryesuesja – Ju, do të thotë ofroni zhvendosjen e tregut në njësinë kadastrale P-72614055-01885-0, me sipërfaqe prej 5,801 m² që evidentohet në emër të Komunës së Obiliqit, e cila në anën veri - lindore ka qasje në rr.”Mentor Dervishaj” ndërsa në anën veri - perëndimore ka qasje në rr.”30 Marsi”.

Enver Gashi – Ne jemi që kjo të kaloj edhe ashtu Infrakosi nuk ka dhënë leje. Ne jemi para një akti të kryer dhe s’ke çka ndryshon aty sepse është pronë e tyre. Mirëpo, thatë se është parcela shumë më e madhe 5,800 metra, që i bjen ne që e marrim vesh shumica afër 60 ari, parcelë bukur e madhe, që mund të zhvillohen aktivitete te tregu normal dhe me standarde të mira.

Sami Ahmeti – Realisht u bë mirë që u shpjegue sepse si kërkesë mua më është dukë pak e paarsyeshme investimi i Komunës, edhe pse qysh në fillim për mendimin tim dhe tonin ka qenë gabim vendosja e tregut ku është për momentin dhe i cili po pritet me u zhvendosë për faktin se as nuk është pozicion dhe është në kushte të këqija. Sido që të jetë për disa kërkesa po merren vendime shumë shpejtë dhe po na vijnë edhe vendimet e Drejtorisë. Do të ishte mirë për secilën kërkesë të qytetarëve dhe të grupeve afariste të jetë njëjtë, e jo në mënyrë selektive sepse po jepet mendimi, përshtypja, që po bëhet krejtë me plan. Realisht ndërton fillimisht një treg, pastaj vjen dikush hiqe se po du me vendosë diçka këtu, ka mundësi me na ardhë mundësia që edhe objektin e Komunës, ka me na thënë dikush hiqe se dojmë me vendosë diçka tjetër dhe unë ua paguaj ato. Për rialokimin e tij në një vend tjetër jemi dakord sepse ka qenë në vend të keq, nuk po dojmë me pa zi krejtë, por është mirë të trajtohen të gjitha kërkesat njëjtë në mënyrë që mos të bëjmë dallime në mes të qytetarëve.

Ajet Berisha – Unë vonë tash po e kuptoj se fjala është për tregun e ri që vetëm sa është ndërtue me u zhvendosë ai. Do të thotë, e keqja e dytë po don të bëhet me u zhvendosë në një vend, ku prapë keni me pasë nevojë me zhvendosë sepse atje tregun ku doni me dërgue përtej hekurudhe, më mirë leni kohë, caktoni një parcelë ku është funksionale që tregun kanë me shfrytëzue qytetarët, e jo treg vetëm sa me thënë. Tregu duhet me qenë sa më afër qytetarëve dhe e para juve po iu ndodhë diçka që ju keni bërë pa plan, e duhet me zhvendosë dhe thoni se kemi investue në parcelën e Infrakosit, që edhe kjo po më çudit qysh keni investue. Pse duhet leje e Infrakosit, tregu qenka ndërtuar në një hapësirë që nuk qenka pronë e jona, për çka duhet Infrakosi me dhënë leje nëse, është pronë e jona. Po thojnë se është prona jonë dhe ndërtimi ynë, pse Infrakosi duhet me dhënë leje.

Kryetari – Sqaron se pikërisht kur është ndërtuar tregu nuk ka qenë ajo zonë e zhvilluar në çfarë rrethana tani është duke ndodhë, është ndërtue një objekt pastaj zhvillimet tjera, që kanë ndodhë. Tregu ka qenë në pronën tonë edhe nëse, hiqet tregu nuk do të kishte mundësi për banorët e atij pallati që është ndërtue tani aty, të kenë lëizje nëse, do të operonte një operatorë i cili e ka në shfrytëzim nga hekurudha. Bëhet fjalë për dy pengesa që i kanë pasë ata. Ne paraprakisht siç tha edhe drejtori e kemi marrë një konsultë prej Infrakosit, që ata nuk do të ia vazhdojnë më tutje kontratën operatorit i cili është duke veprue prapa tregut, me siguri është një operatorë që merret me material ndërtimor. Kjo, pastaj nuk e ndalë si pengesë mos me zhvendosë tregun. Tregu kur është ndërtue nuk ka qenë objekti për të cilin po bisedojmë tani, që e kanë parashtrur kërkesën. Mendoj se do të ketë zhvillime në Obiliq, po punohet gjithëandëj dhe ka ndryshime, mirëpo ne jemi munduar që më afër do ta kenë qytetarët, por nuk ka ndonjë parcelë komunale që kishim mund me shfrytëzue për tregun.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 7 vota abstenim e miratuan Vendimin për caktimin e lokacionit të ri për rivendosjen e Tregut në Njësinë Kadastrale nr. P-72614055-01885-0, me sipërfaqe prej 5,801 m² e cila evidentohet në emër të Komunës së Obiliqit, e cila në anën veri - lindore ka qasje në rr.”Mentor Dervishaj” ndërsa në anën veri - perëndimore ka qasje në rr.”30 Marsi”.

Pika 11 e rendit të ditës

Kryesuesja – Kryetar, në mbledhjen e KPF-së, z.Ahmeti ka paraqitë një kërkesë ku është interesuar me ditë se banesat sociale si Komunë e Obiliqit a kemi aplikuar për eficiencë si dhe një informacion për nënkalimet nënhekurudhore te lagjja B, për çka janë edhe qytetarët të pranishëm në mbledhje.

Kryestari – Sqaron se po kemi aplikuar te projektet për eficiency, janë 2 programe dhe tani është edhe një program i ri te Ministria e pushtetit lokal në sektorin privat. Njëherë për njëherë janë në proces projektet sociale, në të cilat nuk ka intervenime në vitet e fundit. Nëse, nuk gaboj kemi aplikue për 2, ose 3 objekte kolektive. Sa i përket çështjes së nënkalimit ne e kemi diskutue edhe në seancat e mëhershme dhe më vjen mirë që i kemi edhe qytetarët këtu. Ne jemi të gatshëm që prapë ti takojmë qytetarët në zyre, kanë qenë edhe në një takim me Nënkryetarin, pikërisht këtu në Kuvend dhe ne jemi të gatshëm për me iu dhënë sqarime sepse normal që këto punë bëhen për qytetarët. Një nënkalim do të jetë mbi stacionin e hekurudhës, që është tash i ndërtuar dhe tjetri nënkalim do të jetë te pjesa e ndërprerjes me kanalin, që është në pjesën e poshtme te ajo pjesa e Mjekiqëve, në zonën e qytetarëve. Projektet janë në përfundim dhe në momentin kur të përmbyllen si procese bashkë me Ministrinë, do të fillojmë implementimin e tyre. Është fat i madh për neve, që këto mjete financiare vijnë nga fondi i grandit të performancës, projekt në të cilin Komuna jonë renditet në mesin e 38 Komunave, si Komunë e tretë për performancë. Kjo na e ka krijuë mundësinë përndryshe, të gjithë do të mundohemi që ta bënim, por nuk di në aspektin buxhetor qysh kishim me kalue. Tani, për tani mund të them se ka ndryshime në hekurudhë.

Valon Svirca – Unë e kam një kërkesë për çështjen e varrezave në fshatin Mazgit i Ulët, a keni mund me shiku një lokacion tjetër sepse tash nuk ka vend për me u varrosë dhe kjo është një shqetësim më i madh te qytetarët e Mazgitit të Ulët.

Ajshe Haliti Pllana – Unë nuk kam pyetje, ose kërkesa por i kam 2 sqarime që kanë të bëjnë me mbledhjen e parafundit, do të thotë të shkurtit sepse në mars nuk kam mund me qenë prezente. Në mbledhjen e parafundit, në muajin shkurt, unë kam kërkuar që PAP- testi papagesë të rikthehet në Komunën tonë, që dihet se është bërë një kohë papagesë, pastaj është kthye në një formë tjetër me pagesë por, jo në QKMF është bartë dikund tjetër. Është fakt se para disa muajve kam bisedue me drejtoreshën e shëndetësisë lidhur me PAP-testin se e kanë pasë kërkesë prej qytetarëve, që është bërë me pagesë dhe kam kërkuar prej drejtoreshës veç me iu tregue se është me pagesë për shkak se shumica e femrave kuptohet kur shkojnë dikund të papërgatitura për pagesë psh kur e kanë ditë që është papagesë dhe kur është kërkuar pagesa, nuk ka pasë asnjë shqetësim. Do të thotë është zgjidhë gjithçka përmes drejtoreshës dhe unë nuk jam kompetente me ndalue, as nuk e kam ndalue, por është një sqarim për qytetarët faktikisht, e jo me u shpërndarë në QKMF me thënë znj. Ajshe e ka ndalue sepse unë nuk jam kompetente me ndalue PAP-testin, as me rikthye, kjo ka qenë vetëm kërkesë. Sqarimi i dytë është lidhur me barnatoret dhe në atë mbledhjes ka pasë një debat për barnatoret, ku unë nuk kam qenë pjesë e atij debati, meqë kam mendue pse me qenë kur kolegët e kanë sqarue sepse të gjithë jemi për një zgjidhje. Pas 2,3 dite kanë shkue edhe te farmacistja në QKMF, prej këtu kanë shkue dhe i kanë thënë se znj. Ajshe, me një kolegë të vetin kanë me fillue me ardhë me shikue kush po hyn në punë, kush po delë prej punës, i kanë krijuë shqetësime të ndryshme zonjës atje, që punon farmacistes. Unë deshta me iu thënë kolegë të nderuar, kamerat dhe procesverbalet janë këtu, absolut nuk kemi përmendë as unë, as kolegu im z. Sami, sepse ne nuk kemi kompetencë me dalë me përcjellë askend kur shkon në punë dhe kur delë dhe nuk na intereson ajo çështje. Të gjitha çështjet kërkesat, ankesat, sqarimet i sjellim në Kuvend lidhur me qytetarët tonë, që ata i shprehin shqetësimet te ne dhe ne i sjellim në Kuvend.

Kryesuesja – Sa i përket mbledhjeve të Kuvendit dhe sqarimeve, fatmirësisht Komuna e Obiliqit, gjithçka transmeton live dhe çdo kush që dyshon mund të hyj në YouTube dhe mund ta përcjell mbledhjen.

Ajet Berisha – Pyeti meqë, Kryetari tha se janë 2 nënkalime, çfarë lloji janë, a kalojnë vetëm udhëtarët apo edhe veturat.

Valbonë Beka – Unë e kam një pyetje lidhur me ndriçimin në Mazgit të Ulët, ku është problemi që sa muaj jam duke e paraqitë edhe nuk është asnjë përmirësim.

Kryetari – Përgjegjet lidhur me varrezat në Mazgit, është e vërtetë se janë në përmbyllje të hapësirës dhe ne jemi munduar disa herë me banorët e Mazgitit, që me bë një zgjidhje, e cila do të ishte më e mira për vetë banorët sepse është pak e ndijshme. Po ashtu, kemi kërkuar nga z. Esat, me bashkëbisedue edhe me imamin e xhamisë, që me organizue me Këshillin e fshatit për me trajtue si

çështje. Ne jemi të gatshëm nëse, ka hapësirë aty afër për me shpronësue, por edhe kudo që e vlerësojnë banorët me zhvendosë, apo me krijue një lokacion të ri. Sa i përket çështjes që tha e nderuara, asambleiste ka lëvizje qarkullimi gjithëandëj dhe gjithëherë ka me pasë thashetheme. Kolegu juaj, një herë tha se mungojnë letra, printimi, vetë mësimdhënësit shkojnë nëpër shkolla. Nëse, kjo është e vërtetë ne mund të shkojmë bashkarisht nëpër të gjitha shkollat me pa a ka, apo nuk ka. Mund të ketë raste, ne edhe në familje në shtëpi kemi raste kur një pajisje dëmtohet, ose është në defekt por riparohet. Unë sa e di shpërndarja e materialit higjienik, letër ka ndodhë dhe tash a ka pasë ndonjë vonesë, nuk e di, mund të ketë pasë, por sa di tani janë të furnizuar dhe normal që kanë me qarkullue thashethemet. Sa i përket çështjes së vendkalimeve, 2 vendkalime do të jenë dhe do të shohim mundësinë se a do të ketë mundësi për shkak të ujërave nëntokësore me bë për kalim me vetura. Sipas informacioneve, që kemi ne ujërat nëntokësore nuk kanë lejuar që të bëhen për vetura, por do të jenë për këmbësorë. Për ndriçimin në Mazgit të Ulët, besoj se ka me ndodhë meqë, ata janë në proces të kontratës nëse, nuk e kanë përmbyllë dhe në momentin që kontraktohet kompania vijnë.

Fidan Ahmeti – Kryesuese, unë e kam një kërkesë për juve direkt dhe ka të bëjë me llap top sepse na janë bllokuar telefonat prej emailave. Kryesuese, ne të gjithë të kemi ty si shef të shefave atje lartë, pavarësisht partive, kishte me qenë mirë të kujdeseni për neve, për llap topa, për disa gjëra pak më elementare. Kjo, nuk ka të bëjë me asnjë Drejtori, por me juve. Në këtë rast e din se në cilën Drejtori të drejtoresh për me na i sigurue llap topët.

Kryesuesja – Përgjegjet se paraprakisht e kam bërë një shkresë qysh më heret dhe ju kam tregue edhe në Kuvend, para se të nxjerret një vendim dhe Drejtorja e administratës më ka thënë se duhet të nxjerret një vendim i veçantë për furnizim me llap top në Kuvend. Në Kuvend, e kemi paraqitë dhe kemi nxjerrë vendim, por pas një muaji Ministria e financave ka kërkuar informata shtesë, kodin buxhetor prej nga merren mjetet dhe bashkë me drejtoreshën e financave, e kemi dërguar kodin buxhetor, do të thotë gjithçka kemi sqaruar. Në vendimin që kemi nxjerrë e kam potencuar saktësisht se llap topët mund të shfrytëzohen vetëm gjatë mandatit të anëtarit të Kuvendit dhe në fund duhet ti kthehet Komunës, sepse është aset i Komunës. Pra, na është lejuar, por për procedurat tjera, nuk e di qysh kanë mbetë në Prokurim, te drejtoresha e administratës.

Lendita Bekteshi – Ju njoftoj se pas vendimit që e keni marrë në Kuvend, menjëherë e kemi dorëzue projektin në Prokurim dhe është bërë vlerësimi, kështu që jemi pothuajse në fazën e fundit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:7'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi

